

|                                                               |         |         |       |
|---------------------------------------------------------------|---------|---------|-------|
| REPUBLIKA E KOSOVËS<br>KOMUNA GLLOGOC<br>GLLOGOC MUNICIPALITY |         |         |       |
| Pranuar                                                       |         | 28/12   | 2020  |
| Nj. Org.                                                      | Numër   | Shtojca | Vlera |
| 01-                                                           | 060/03- | 53503   |       |

**PROCESVERBAL NGA TAKIMI I KËSHILLIT KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI (KKSBB)  
IZVEŠTAJ O SASTANKU OPŠTINSKOG ODBORA ZA BEZBEDNOST ZAJEDNICE (OOBZ)**

**Komuna / Opština: Drenas    Data / Datum: 17.11.2020**

**Numri i takimit për këtë vit / Redni broj sastanka u ovoj godini: 8**

**Takim i rregullt / Redovni sastanak ☒**

**Takim i jashtëzakonshëm / Vanredni sastanak**

**Numri i anëtarëve të KKSBB-së të pranishëm / Broj prisutnih članova OOBZ: 16**

**A kanë marrë pjesë në takim përfaqësuesit e komuniteteve jo shumicë, nëse janë anëtarë të KKSBB-së?  
Da li su predstavnici nevećinskih zajednica, u svojstvu članova OOBZ, prisustvovali sastanku?**

Po / Da ☐

Jo / Ne ☐

Nuk ka anëtarë që përfaqësojnë komunitetet jo shumicë/Nema članove koji predstavljaju nevećinske zajednice ☒

**A kanë marrë pjesë anëtarë të tjerë përveç anëtarëve të KKSBB-së?  
Da li je neko osim članova OOBZ prisustvovao sastanku?**

Po / Da ☒ LMT K-9 e KFOR-it Zviceran.

Jo / Ne ☐

*Nëse "Po", ju lutem potenconi organizatën të cilën e përfaqësojnë  
Ukoliko je odgovor "Da", molimo navedite koje organizacije predstavljaju*

**A është kryesuar takimi nga Kryetari i Komunës apo nënkryetari?  
Da li je sastankom predsedavao Gradonačelnik ili Zamenik?**

Po / Da ☒ Nënkyetari

Jo / Ne ☐

**Temat në rendin e ditës / Teme na dnevnom redu:**

Në mbledhje u diskutuan këto pika të rendit të ditës:

1. Procesverbali i mbledhjes së jashtëzakonshme të KKSBB-së të mbajtur me 11.11.2020, i disponueshëm në linkun: <https://kk.rks-gov.net/gllogoc/wp-content/uploads/sites/10/2020/11/Procesverbali-i-mbledhjes-se-jashtzakonshme-te-KKSBB-se-11.11.2020.pdf>
2. Njoftim për gjendjen epidemiologjike dhe masat e ndërmarra në Komunën e Drenasit pas kalimin në Zonën e Kuqe;
3. Raportim për përfundimin e gjysmëvjetorit të parë;
4. Raportim nga Zyra për Komunitet dhe Kthim për procesin e ri-integrimit e personave të riatdhesuar;
5. Të ndryshme.

*Ju lutem, potenconi temat tjera për të cilat është diskutuar në të ndryshmet / Molimo navedite druge teme o kojima se diskutovalo:*

| REPUBLIKA E KOSOVËS<br>KOMUNA GLLOGOC<br>GLLOGOC MUNICIPALITY |         |         |       |
|---------------------------------------------------------------|---------|---------|-------|
| Pranuar                                                       | 28/12   |         | 2020  |
| Nj. Org.                                                      | Numër   | Shtojca | Vlera |
| 01-                                                           | 060/63- | 53503   |       |

### Konkluzionet / Zaključit:

Procesverbali i mbledhjes paraprake u miratua unanimisht dhe pa ndonjë vërejtje.

Drejtori i Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Arsim Haxhiu, i ka njoftuar anëtarët e KKSB-së për bashkëpunimin e rregullt me IKSHIP-në sa i përket emrave të të infektuarve, dhe me statistikën e të infektuarve. Ai ka shtuar se që nga marsi i këtij viti deri me datën 16.12.2020, në Drenas, janë prekur 1027 persona, prej tyre janë 333 raste aktive dhe 650 të tjerë janë shëruar. Haxhiu gjithashtu i njoftoi të pranishmit se përmes informimit publik janë njoftuar qytetarët që trajtohen nga virusi SARS-COV-2 se përveç rasteve urgjente, ata mund të kontaktojnë përmes telefonit numrin pa pagesë 194, në mënyrë që të caktohet vend i lirë për marrjen e terapisë infuzive, në mënyrë që të shmangen pritjet dhe fluksi i madh i njerëzve dhe për një organizim më të mirë të marrjes së shërbimeve mjekësore. Ekipet mjekësore janë të gatshme nga ora 8:00 e mëngjesit deri në ora 20:00 në kuadër të kapaciteteve të veta ekzistuese në dy qendrat e saj, QKMF në Drenas dhe QMF në Komoran të ofrojnë shërbime shëndetësore, ndërsa pas orës 20:00 është ekipi kujdestar i rregullt që mund të ofrojë shërbime për të infektuarit me COVID-19. Terapia standarde infuzive për trajtim COVID-19 ekziston përjashtimisht pjesës vitaminoze. Gjithashtu, në barnatoren e QKMF-së, gjatë orarit të barnatores, mund të merret komplet terapia orale për trajtimin e COVID-19. Kapacitetet e trajtimit me COVID-19 janë deri në 48 pacientë dhe menaxhimi është nën kontroll.

Drejtori i Drejtorisë Komunale për Arsim, Muhamet Gjoka, paraqiti një përmbledhje të situatës aktuale, tashmë në përfundim të gjysmëvjetorit të parë dhe për sfidat me të cilat është ballafaquar kjo drejtori, për skenarët e ndjekur në disa shkolla, dhe për sukseset e nxënësve të Komunës së Drenasit të cilët përkundër pandemisë kanë arritur rezultate të mira në gara të ndryshme. Njëherësh, i njoftoi të pranishmit me investimet në shkolla që arrijnë shumën 900 mijë euro, dhe si rezultat të gjitha shkollat janë pajisur me laboratorë dhe janë vendosur nën vëzhgim me kamera. Gjithashtu, falënderoi edhe KFOR-in Zvicëran për ndihmën në vendosjen e kontakteve me drejtoritë e arsimit në disa kantone të Zvicrës, për të shkëmbyer përvojat për klasa të përziera të nxënësve, duke pasur parasysh zvogëlimin e numrit të nxënësve në zonat rurale të komunës sonë.

Për pikën e katërt të rendit të ditës, shefja e Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim (ZKKK), Afije Veseli, tha se në Komunën e Drenasit gjatë vitit 2020 janë riatdhesuar 7 persona dhe një familje 7 anëtarëshe. Nga këta 7 persona – dy (2) raste janë raste të cënueshme. Ndër të tjera, shefja e ZKKK-së informoi të pranishmit për sfidat me të cilat janë ballafaquar disa nga të riatdhesuarit për regjistrimin e fëmijëve në shkolla, për angazhimin e zyrës që ajo drejton, si dhe mundësitë e ofruara për të riatdhesuarit për vetëpunësim, subvencionim në punësim dhe trajnim për punë.

Procesverbali u përpilua nga koordinatori i KKSB-së:

Izveštaj pripremio Koordinator OOBZ: Arben Shala

(emri, mbiemri dhe nënshkrimi dhe prezime i potpis)

Procesverbali aprovohet nga Kryetari:

Izveštaj odobrava Gradonačelnik: Ramiz Lladrovi

nënshkrimi i potpis

Data e aprovimit / Datum odobranja: 28.12.2020

### Rekomandimet:

- Dërgimi i këtij procesverbali është obligim që del nga UA 27/2012 MPB – 03/2012 MAPL neni 11 pika 6;
- Procesverbali përpilohet nga koordinatori i KKSB-së në Komunën përkatëse;
- Procesverbali duhet të dërgohet në MPB në e-mail adresën: [mpb.dsb@rks-gov.net](mailto:mpb.dsb@rks-gov.net)
- Procesverbali duhet të dërgohet në MAPL në e-mail adresën: [Shkrimorja.Mapl@rks-gov.net](mailto:Shkrimorja.Mapl@rks-gov.net)
- Procesverbali duhet të dërgohet njëkohësisht me ftesën e takimit të ardhshëm të KKSB-së.

|                                                               |        |         |       |
|---------------------------------------------------------------|--------|---------|-------|
| REPUBLIKA E KOSOVËS<br>KOMUNA GLLOGOC<br>GLLOGOC MUNICIPALITY |        |         |       |
| Pranuar                                                       |        | 09/12   | 2020  |
| Nj. Org.                                                      | Numër  | Shtojca | Vlera |
| 01-                                                           | 06063- | 53503   |       |



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**KOMUNA DRENAS**  
**Zyra e Kryetarit**  
**Drenas, më 09.12.2020**

Në bazë të Udhëzimit Administrativ nr. 27/2012 MPB — 03/2012 MAPL për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi, përkatësisht nenit 9 pika 1.3, dhe Vendimit nr. 12-030-786, datës 04.01.2018, të Kuvendit Komunal, thirret mbledhja e jashtëzakonshme e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSBS), në emër të Kryetarit të Komunës, Ramiz Lladrovci, ju drejtojmë këtë:

**F T E S Ë**

Për anëtarin/en \_\_\_\_\_ nga \_\_\_\_\_  
që të marrë pjesë në mbledhjen e jashtëzakonshme të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSBS) lidhur me zhvillimet e fundit në Komunën e Drenasit.

Mbledhja e rregullt mbahet më datën 17.12.2020, e enjte, me fillim në orën 14:00, në Sallën e Kuvendit.

**Rendi i ditës:**

1. Procesverbali i mbledhjes së jashtëzakonshme të KKSBS-së të mbajtur më 11.11.2020, i disponueshëm në linkun: <https://kk.rks-gov.net/gllogoc/wp-content/uploads/sites/10/2020/11/Procesverbali-i-mbledhjes-se-jashtzakonshme-te-KKSBS-se-11.11.2020.pdf>
2. Njoftim për gjendjen epidemiologjike dhe masat e ndërmarra në Komunën e Drenasit pas kalimit në Zonën e Kuqe;
3. Raportim për përfundimin e gjysmëvjetorit të parë;
4. Raportim nga Zyra për Komunitete dhe Kthim për procesin e ri-integrimit e personave të riatdhesuar;
5. Të ndryshme.

Kopje: Anëtarëve të KKSBS-së



Kryetari i Komunës

Ramiz Lladrovci